

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil : me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe sekretaren juridike Mirvete Ahmeti, në çështjen juridiko civile të Paditësit B.M.nga fshati B., Komuna e P. të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.P. avokat me seli në Rr.”....” nr..., Komuna e P. kundër të Paditurës Kompania e Sigurimeve “I.” sh.a me seli në P., në çështjen kontestimore kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të paditësit B. M., përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat A. P., dhe përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës A. P. – D., me datë 12.11.2013 morri këtë :

A K T G J Y K I M

- I. Pjesërisht aprovohet** kërkesëpadia e Paditësit B.M. nga fshati B., Komuna e P., **SI E BAZUAR.**
- II. Detyrohet** e Paditura Kompania e Sigurimeve “I.” sh.a me seli në P., t’ia paguan Paditësit B.M. për aksidentin e dt.06.12.2011 si pasojë e lëndimeve të pësura dhe atë në emër të kompensimit të dëmit jo material shumë prej 1.800,00 Euro, e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës, kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e parashtrimit të padisë dt.20.12.2011 e të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi dhe atë :

Në emër të dëmit jo material :

- Në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 900,00 Euro;
- Për frikë të përjetuar shumë prej 900,00 Euro.

III. Përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 100,00 Euro për paditësin B.M. dhe kërkesa për ushqim të sforcuar, për ndihmë dhe kujdes të huaj, për rehabilitim klimaterik, **REFUZOHEN SI TË PABAZUARA;**

- III. DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve "I." me seli në P. që paditësit t'ia kompensoi në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 759,00 €uro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi në padi, dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar të saj ndër të tjera ka deklaruar se me datën 06.12.2011, në fshatin B., Komuna P., është shkakuar aksident trafiku, nga i cili aksident trafiku Paditësi B. M., ka pësuar lëndime trupore, po ashtu ka deklaruar se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te e Paditura.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 12.11.2013 përfaqësuesi i autorizuar i Paditësit avokat A. P., mbeti në tërësi pranë precizimit të padisë të bërë në procesverbal në këtë gjykatë më 12.11.2013, po ashtu në baze të shkresave të lëndës i propozoi gjykatës që padinë dhe kërkespadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

E paditura në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 12.11.2013 nëpërmes përfaqësueses të autorizuar të saj A. P. – D. ka deklaruar se edhe më tutje mbesim në tërësi pranë përgjegjes në padi, si dhe pranë deklarimeve nga seancat e kaluara. Ndërsa, lidhur me precizimin e kërkesëpadisë, përfaqësuesja e të paditurës deklaroi se e kundërshton në tërësi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 12.11.2013 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike siç janë : raporti i Aksidentit i përpiluar nga Policia e Kosovës me nr. të rastit 2011-AF-1783 dt.06.12.2011, Raporti nga QKUK Prishtinë – Qendra Emergjente Prishtinë me nr. Të raportit 37574 dt.06.12.2011, aktmarrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit të kërkuar e dt.07.03.2012, urdhër transferi bankar dt.03.05.2012 për pagesën e dëmit të paditësit për dëmin në baze të aktmarrëveshjes dt.07.03.2012, procesverbali i hartuar pranë kësaj gjykate më dt.18.10.2013 në të cilin procesverbal e kanë dhënë mendimin dhe konstatimin ekspertët mjekësor dhe atë Dr. B. I. – Ortoped, dhe Dr.N. M.– psikiatër, pas ekzaminimit objektiv, dhe shkresave të lëndës për paditësin B. M., fletëpagesa e dt.18.10.2013 për kompensimin e ekspertëve të ftuar të bëra nga paditësi B. M., si dhe provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi se :

- Në bazë të raportit të Aksidentit i përpiluar nga Policia e Kosovës me nr. të rastit 2011-AF-1783 dt.06.12.2011, u vërtetua se me dt.06.12.2011, ka ndodhur aksident trafiku në të cilin aksident Paditësi ka pësuar lëndime trupore.

- Në bazë të akt marrëveshjes për pranimin e vlerës së dëmit të kërkuar dt.07.03.2012, u vërtetua se Paditësi B.M. ka nënshkruar akt marrëveshje me të Padituren për kompensimin e vetures me targa *numër i targave...* së dëmtuar në aksidentin e dt.06.12.2011 në shumë prej 1.700,00 €uro.

Në rastin konkret Gjykata mendimeve të ekspertëve ia dha besimin e plotë dhe i miratoj ne tërësi ekspertizat e kryera të cilat kanë elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore dhe atë ;

- Ekspertizës të bërë nga eksperti mjekësorë Dr.B. I., ortopedë-traumatologë i cili ndër të tjera ka konstatua se Paditësi B.M. në aksidentin e përjetuar ka pësuar : ***“shtypje të qafës dhe unazave të qafës, shtypje të regjionit të belit...”***.

Po ashtu ka konstatuar se Lëndimi karakterizohet si *lëndim i lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, i cili ka shkaktuar dhimbje fizike me llojet e intensiteteve të dhëna në ekspertizë.*

- Mendimit të dhënë nga ekspertja mjekësore Dr. N. M., psikiatër, në shqyrtimin kryesor të dt.18.10.2013, e cila ndër të tjera ka konstatua se Paditësi *B.M. në aksidentin e dt.06.12.2011 ka përjetuar frikë primare në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi I drejtëpërdrejt për integritet fizik që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka vazhduar për 24 orë të manifestuar me ankth. Pa aftësinë për tu qetësuar, shqetësime emocionale manifestuar me disponim jo të qëndrueshëm, problem me gjumin gjatë natës si dhe me nervozë, ...”*.

-Në lidhje me bazën juridike, e paditura në përgjigjen në padi, dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar padinë dhe kërkespadinë e paditësit si dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoi si të pa bazuar në tërësi.

Ndërsa paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij ka deklaruar se në përgjithësi i kundërshtoi thëniet e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës duke deklaruar se me rastin e kompensimit të dëmit se paditësi ka deklaruar se nuk ka kurrfarë pretendimi tjetër financiar ndaj të paditurës vetëm në kuptim të dëmit material të shkaktuar në automjetin e tij e jo edhe për kërkesat tjera dhe për dëmtimet tjera që i ka pësuar në aspektin shëndetësor sikur që janë precizuar në kërkesëpadi.

Andaj, në rastin konkret Gjykata duke u bazuar në pretendimet e të paditurës lidhur me kundërshtimin e bazës juridike, si dhe duke u bazuar në Akt marrëveshjen për pranimin e vlerës së dëmit të kërkuar të lidhur me datë 07.03.2012 ndërmjet paditësit dhe të paditurës, Gjykata vërejtë se në bazë të kësaj akt marrëveshje paditësi është kompensuar vetëm për dëmin e automjetit ndërsa për dëmin jo material nuk është kompensuar.

Ndërsa për pretendimet e të paditurës se me rastin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshje paditësi ka deklaruar se nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj kësaj kompanie, gjykata e vërejtë se në këtë akt marrëveshje objekt kompensimi ka qenë vetëm dëmi në automjet.

Po ashtu në këtë procedurë kontestimore kontestuese mbetet edhe lartësia e dëmit e precizuar nga i autorizuari i paditësit me parashtresën e dt. 25.06.2013.

Lidhur me lartësitë dhe shumat e aprovuara për kompensimin e dëmit jo material për Paditësin B.M.të përmendura sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi janë aprovuar bazuar në nenin 200 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, si dhe bazuar në nenin 323 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, po ashtu me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit kjo gjykatë pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, intensitetin e dhimbjeve, kohëzgjatjen e tyre, intensitetin e frikës, dhe shumat e caktuara do të ofrojnë satisfakcion të duhur për dhimbjet e përjetuara dhe do të ndikojnë në vënien e baraspeshës psikike dhe emocionale duke i refuzuar për tej pjesës së gjykuar shumat që në parashtresë i ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i Paditësit duke u bazuar në atë që shumat e aprovuara të mos i shkojnë përshtati synimeve të njëres palë për fitim pa bazë dhe kundër interesit të përgjithshëm shoqëror.

Kërkesa për ushqim të përforcuar, kërkesa për ndihmë dhe kujdes të huaj, si dhe kërkesa për rehabilitim fizioterapeutik – klimatik për paditësin B.M. u refuzuan si të pabazuara në mungesë të provave.

Gjykata paditëses për veç kërkesës kryesore ja njohu, edhe kërkesën me kamatë vjetore të cilën e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës për mjete të deponuara për një vitë pa destinim të caktuar për të gjitha format e dëmit nga dita kur është dhënë mendimi i ekspertit të ortopedisë dhe për kamatën vjetore Gjykata zbatoi dispozitat e neneve 277, 278 të LMD-së, duke vendosur si në dispozitiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata u bazua në nenin 452.2 par.2 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së Odes së Avokatëve të dt.01.12.2012, dhe atë shpenzimet për 3 përfaqësime në seanca gjyqësore shumë nga 405 Euro, për përpilim e padisë shumë prej 104 Euro, për shpenzime të ekspertizave mjekësore shumë prej 200 Euro si dhe taksa për padi dhe taksa gjyqësore për aktgjykim në shumë prej 50 Euro.

Prandaj, nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 185, 200, 201 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve dhe konform nenit/eve 4, 5, 7, 8 10, 321, 323 147.1, 452 dhe dispozitave tjera të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË

Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.423/11 datë 12.11.2013

**Gjyqtari,
Bujar Muzaqi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh,nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.